

# ÇËSHTJA SHQIPTARE DHE SIGURIA RAJONALE

Nga **Xhavit Shala**

## 1. Hyrje

Në vigjilje të shembjes së Perandorisë Osmane, Kongresi Berlinit, i vitit 1878, do të kishte një ndikim të jashtëzakonshëm në gjeopolitikën e sigurinë ballkanike të asaj periudhe e deri në ditët e sotme. Traktati i Berlinit, në të vërtetë, krijoi një kuadër ligjor ndërkombëtar, i cili mbolli klimën e urrejtjeve ndëretnike dhe krijoi terren për një seri konfliktesh të përgjakshme në rajonin e Ballkanit, pasojat e së cilës nuk janë neutralizuar akoma plotësisht edhe në ditët e sotme. Me vendimet e atij kongresi, Fuqitë e Mëdha shpërfillën me kokëfortësi ekuilibrin demografik të shqiptarëve në Ballkan dhe gjymtuan rëndë territoret e tyre. Me vendimet e Konferencës së Londrës në vitet 1912-1913, megjithëse e njohën shtetin e pavarur, të porsa shpallur shqiptar, aktorët kryesorë gjeopolitikë të kohës i shkëputën shqiptarëve më shumë se gjysmën e territoreve me gjithë popullsinë, duke ia aneksuar ato shteteve fqinje. Ndonëse copëtimi i hapësirës gjeopolitike shqiptare u bë gjoja “për hir të paqes në Evropë”, ky ishte investimi më i keq që Fuqitë e Mëdha bënë për paqen dhe sigurinë në rajonin e Ballkanit.

Me shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë çështja jonë kombëtare dhe çështja shqiptare në rajon u zgjidh vetëm pjesërisht. Pa zgjidhjen e kësaj çështjeje paqja dhe siguria në rajon do të ishin në vazhdimësi të rrezikuara.

Për domosdoshmërinë e zgjidhjes së çështjes shqiptare tashmë u bindën dhe aktorët kryesorë gjeopolitikë euroatlantikë. Por kjo ndodhi vetëm pas shpërthimit të luftës çlirimtare të shqiptarëve të Kosovës për pavarësi dhe rikthimit të krizës jugosllave atje ku nisi, në Kosovë.

Evoluimi nga mendimi se paqja në Ballkan arrihej duke copëtuar trojet etnike shqiptare deri tek bindja se pa zgjidhur çështjen shqiptare nuk mund të ketë paqe e siguri në rajon, është një zhvillim mjaft i rëndësishëm për zgjidhjen përfundimtare të çështjes kombëtare shqiptare, por dhe të çështjes shqiptare në rajonin e Ballkanit.

Shpallja e pavarësisë së Kosovës dhe nënshkrimi i marrëveshjes së Ohrit, shënojnë një fitore historike për shqiptarët në rajon, një hap mjaft të rëndësishëm jo vetëm drejt zgjidhjes përfundimtare të çështjes sonë kombëtare, por dhe për paqen dhe sigurinë rajonale.

Por si lindi dhe u zhvillua çështja shqiptare në Ballkan? A mund të konsiderohet se ajo është zgjidhur përfundimisht sipas programin të Rilindjes Kombëtare? Deri ku janë të gatshëm të lëshojnë aktorët e sotëm kryesorë gjeopolitikë për këtë çështje në raport me kërkesat e shqiptarëve?

Cila është e ardhmja dhe politikat e sigurisë kombëtare për zgjidhjen e saj?

## **2. Shqiptarët në Ballkan, autoktonë në hapësirën e tyre gjeopolitike.**

Në rajonin e Ballkanit, gjatë periudhës së Perandorisë Osmane, shqiptarët banonin në pjesën perëndimore të Gadishullit, në trojet e tyre autoktone ku kishin jetuar gjatë gjithë historisë. Me gjithë rrudhjen e pësuar në Mesjetë, trungu etnik përfshinte, në mesin e shek. XIX, viset e Gegërisë së bashku me Kosovën dhe të Toskërisë ku përfshihej edhe Çamëria, me një sipërfaqe prej rreth 52 mijë kilometra katrorë dhe me një popullsi rreth 1 300 000 banorë. Së bashku me banorët shqiptarë të brezit anësor, numri i popullsisë shqiptare arrinte në atë periudhë në rreth 1 500 000 frymë. Nën sundimin osman, trojet shqiptare mbetën përgjithësisht të ndara në katër vilajete. Në secilin nga këto vilajete u përfshinë edhe kombësi të tjera. Megjithatë, shqiptarët përbënin shumicën e popullsisë në çdonjërin prej tyre dhe në të katër vilajetet të marra së bashku. Në total, në të katër vilajetet, shqiptarët përbënin 61,7 % të numrit të përgjithshëm të popullsisë. Kjo shifër është afërsisht 3% më pak se sa janë maqedonasit etnikë sot në shtetin unitar të Maqedonisë. Gjatë dhjetëvjeçarëve të fundit të sundimit osman, popullsinë më të madhe e kishte vilajeti i Kosovës, i cili kishte në të njëjtën kohë edhe numrin më të madh të popullsisë shqiptare. Pastaj vinin me radhë vilajeti i Manastirit, i Janinës dhe i Shkodrës.

## **3. Rilindja kombëtare shqiptare dhe gjeopolitika rajonale.**

Pas katër shekujsh të sundimit osman, në shekullin e XIX, për popujt ballkanas, fillon epoka e rilindjes së tyre kombëtare. Përfshirja e Ballkanit në sferën e interesave gjeopolitike të Fuqive të Mëdha dhe mbështetja që këto të fundit i dhanë vendeve jo myslimane të Ballkanit, ishte njëri nga kushtet që i bëri të suksesshme lëvizjet për pavarësi të këtyre vendeve.

Shekulli XIX, edhe për shqiptarët, shënoi fillimin e periudhës së Rilindjes Kombëtare e cila shtrihet nga vitet '30-'40 të atij shekulli dhe deri në Shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë më 1912.

Në kushtet e ndryshimeve të mëdha në gjeopolitikën e Ballkanit dhe të mungesës së strukturave shtetërore shqiptare, Rilindja Shqiptare dhe lëvizja që ajo frymëzoi, synoi të identifikojë, të gjejë dhe të shfrytëzojë të gjitha mjetet dhe mënyrat për të mbrojtur e konsoliduar interesat gjeopolitikë të shqiptarëve në rajon.

Ajo synoi të zgjidhte detyrat për çlirimin e vendin nga sundimi osman, të bashkonte trojet shqiptare në një shtet të vetëm e të pavarur e të hapte rrugën e zhvillimit e të përparimit ekonomik-shoqëror, politik e kulturor të Shqipërisë. Kështu lindi dhe çështja shqiptare në Ballkan, çështje e cila kërkonte zgjidhje.

Rilindja Shqiptare, ndryshe nga vendet e tjera ballkanike, u detyrua ta orientonte luftën e saj në dy fronte njëkohësisht: kundër sunduesve osmanë për çlirimin kombëtar dhe kundër lakmive shoviniste të shteteve fqinje, për mbrojtjen e tërësisë territoriale të Shqipërisë.

Lufta për çlirimin kombëtar dhe për formimin e shtetit kombëtar shqiptar, ashtu si për vendet e tjera të Ballkanit, nuk mund të zhvillohej jashtë ndikimit të Fuqive të Mëdha dhe interesave të tyre gjeopolitike në rajonin e

Ballkanit. Por, ndryshe nga vendet e tjera ballkanike, roli i fuqive të mëdha për shqiptarët, me ndonjë përjashtim, ka qenë negativ dhe pengues.

Ky qëndrim mospërfillës, përveç interesave të tyre gjeopolitike në rajonin e Ballkanit, ka qenë përcaktuar edhe nën ndikimin e faktorit fetar. Kështu, besimi fetar i njejtë, ka qenë njëri ndër faktorët nxitës jo vetëm për Rusinë, por dhe për Fuqitë e tjera të Mëdha evropiane që të përkrahnin lëvizjen kombëtare të popujve të krishterë të Ballkanit. Ndërkaq, lëvizja kombëtare e popullit shqiptar, shumica e të cilit i përkiste fesë myslimane, përgjithësisht nuk ka gëzuar një përkrahje të tillë, ndonëse ashpërsia e luftës së shqiptarëve kundër pushtuesve turq rrallë mund të jetë e krahasueshme në Ballkan.

Rilindja ngriti në një shkallë më të lartë organizmin dhe drejtimin e lëvizjes çlirimtare shqiptare. Nga kuvendet e besëlidhjet krahinore e u kalua në formimin e organizatave drejtuese gjithëkombëtare, që drejtonin lëvizjen në shkallë kombëtare, siç qenë Lidhja Shqiptare e Prizrenit (1878-1881) e Lidhja Shqiptare e Pejës (1899-1900) gjatë shek. XIX, si dhe komitetet e ndryshme kombëtare që u krijuan në fazën e fundit të Rilindjes. Krijimi i organizatave të tilla diktohej nga karakteri i përgjithshëm kombëtar i objektivave të Rilindjes dhe nga domosdoshmëria e shtrirjes së njëkohshme të lëvizjes në të gjithë hapësirën gjeopolitike shqiptare.

#### **4. Çështja kombëtare shqiptare mes “Megali Ideas” greke dhe “Naçertanies” serbe**

Çështjes kombëtare shqiptare, që në fillimet e saj i është dashur të mbijetojë mes darës së programit grek të “Megali Ideas” dhe atij serb të “Naçertanies”. Të dyja këto programe kanë patur e kanë karakter të theksuar shovinist. Ato nuk e pranonin ekzistencën e kombit e të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare dhe kundërshtonin idenë e krijimit të shtetit shqiptar. Sipas këtyre programeve, tokat shqiptare ishin të destinuara të ndaheshin midis Greqisë dhe Serbisë.

Prej viteve 40 të shek. XIX, këto synime të shteteve fqinje, u shndërruan në një politikë të përhershme zyrtare, e cila u kthye në një kërcënim permanent për gjeopolitikën e sigurinë e shqiptarëve në rajonin e Ballkanit.

Kryeministri grek Jorgos Koleti, në fillim të vitit 1844, e formuloi dhe e shpalli zyrtarisht programin politik ekspansionist, i cili hyri në histori me emrin “Megali Idhea”. Sipas këtij programi, Greqia, si trashëgimtare e Bizantit, duhej të shndërrohej në një shtet të madh me kryeqytet Kostandinopojën (Stambollin). “Megali Idhea” përfshinte në kufijtë e Greqisë së Madhe edhe tokat shqiptare dhe parashikonte aneksimin tyre..

Po atë vit, kur kryeministri grek Jorgos Koleti shpalli “Megali Idea”-n, më 1844, edhe Ilia Garashanin, kryeministri i ardhshëm serb do të shpallte “Naçertanien”, program i cili do të vihej në themel të politikës së ardhme serbe. Sipas tij, shteti serb duhej të përfshinte jo vetëm të gjithë tokat e të sllavëve të jugut që ndodheshin nën Perandorinë Osmane por të gjithë territoret që dikur përfshiheshin në perandorinë mesjetare të Stefan Dushanit. Në kufijtë e kësaj perandorie të re, sipas “Naçertanies”, do të hynin edhe viset e Shqipërisë së Veriut së bashku me Kosovën, të cilën e pagëzuan me emrin “Serbia e Vjetër”.

Zbatimi në kohët moderne, i këtyre platformave të vjetra nacionaliste, e zhyti Ballkanin pas viteve '90, në katër luftëra të përgjakshme, gjatë procesit të shpërbërjes së ish Jugosllavisë dhe tensionoi herë pas here marrëdhëniet e Greqisë me Shqipërinë, Maqedoninë e Turqinë.

### **5. Lëvizja kombëtare, shpallja e pavarësisë dhe fuqitë e mëdha.**

Kryengritjet maratonë të shqiptarëve për të pasur shtetin e tyre, sidomos ajo e përgjithshme e vitit 1912, përgatitën truallin për Shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë. Kryengritja Shqiptare e vitit 1912, me vatër kryesore vilajetin e asaj kohe të Kosovës, me kryeqendër Shkupin, ishte vullkani që plasariti themelet e Perandorisë Osmane. Kuvendi i Vlorës shpalli pavarësinë e Shqipërisë më 28 nëntor 1912. Fuqitë e Mëdha u detyruan të njohin shtetin shqiptar, vetëm pasi ai u bë fakt i kryer nga Kuvendi i Vlorës.

### **6. Çështja kombëtare shqiptare mes dy luftërave botërore**

Katër nga gjashtë Fuqitë e Mëdha evropiane dhe konkretisht Britania e Madhe, Franca, Rusia dhe Mbretëria Italiane, të cilat kishin nënshkruar njohjen e Pavarësisë së Shqipërisë më 29 korrik 1913 dhe kishin pranuar kufijtë politikë që ajo ka sot, ishin marrë vesh që në mbarim të Luftës së Parë Botërore, po ta fitonin luftën, ta copëtonin Shqipërinë dhe të shpërblenin me territoret e saj Serbinë në veri, Greqinë në jug, Italinë në Vlorë. Me pjesën që do të mbetej, në Shqipërinë e Mesme, do të krijohesh një minishtet mysliman shqiptar nën protektoratin e Italisë.

Palët fituese, me mbarimin e Luftës I-rë Botërore, në Janar 1919 organizuan në Paris Konferencën e Paqes. Ashtu siç i ishte premtuar në Traktatin e Fshehtë të Londrës, Italia kërkoi sovranitetin e plotë mbi qytetin e Vlorës me gjithë hinterlandin e nevojshëm për zhvillimin ekonomik të saj si dhe mandatin për administrimin dhe përfaqësimin në arenën ndërkombëtare të pjesës tjetër të mbetur të shtetit pavarur shqiptar. Në Konferencë, edhe serbët po luanin të gjithë "gurët" dhe për të siguruar një dalje në det.

Në Konferencën e Paqes, fuqitë fituese, propozuan për Shqipërinë në veri dhe në lindje, ata kufij që i patën caktuar në Konferencën e Londrës në vitin 1913; ia njohën Italisë sovranitetin e plotë mbi Vlorën dhe prapavijën e nevojshme dhe ia dhanë Italisë mandatin për administrimin e shtetit të lirë shqiptar nën kontrollin e Lidhjes së Kombeve. Në këtë mënyrë, Konferenca e Versajës, sanksionoi ndarjen dhe legalizoi dhënien e territoreve shqiptare fqinjëve tanë. Por shqiptarët nuk mund të pajtoheshin me këto vendime. Për këtë, me 28-31 janar 1920 u zhvillua në Lushnjë Kongresi me të njëjtin emër. Kongresi denoncoi menjëherë vendimet e Traktatit të Londrës. Gjithashtu Kongresi Lushnjes shpalli mosnjohjen e të drejtës së kontrollit të Fuqive të Mëdha.

Kuvendi i Vlorës shpalli pavarësinë e Shqipërisë ndërsa Kongresi i Lushnjes e realizoi plotësisht në praktikë atë.

Periodha gjatë viteve 1921-1924 në Shqipëri, i përket periudhës së përpjekjeve për forcimin e një demokracie parlamentare, ndryshe nga regjimet mbretërore të fqinjëve tanë.

Më pas, vitet 1925-1939, përbëjnë një periudhë komplekse dhe mjaft të tendosur për historinë e Shqipërisë dhe për pozitën e vendit në Ballkan dhe në Evropë. Pozicioni i Shqipërisë në Ballkan kishte kohë që ishte përfshirë në planet strategjike italiane për zotërimin e Detit Adriatik dhe të gjithë Mesdheut. Mbreti Zog u tregua i gatshëm të merrte pjesë në procesin e depërtimit italian në Ballkan. Pas shumë negociatash me italianët, Zogu detyrohet të nënshkruajë dy traktate të rëndësishme në fushën e sigurisë. Më 27 nëntor 1926 “Paktin e miqësisë dhe të sigurimit”, që pasohet një vit më vonë, më 22 nëntor 1927, me “Traktatin e Aleancës Mbrojtëse”. Me këto dy pakte politike e ushtarake, Shqipëria në të vërtetë bëhej protektorat italian. Por italianëve nuk i mjaftonte më protektorati mbi Shqipërinë. Duhej aneksimi i plotë i saj. Për këtë, pasi kishin arritur të vinin nën kontroll ekonominë, administratën shtetërore, ushtrinë, dhe pasi kishin zënë pozita të rëndësishme strategjike në vend, ata kaluan në fazën finale, në agresion ushtarak kundër Shqipërisë me 7 Prill 1939.

### **7. Lufta e Dytë Botërore, shqiptarët dhe gjeopolitika rajonale**

Lufta e Dytë Botërore e gjeti të pazgjidhur çështjen shqiptare. Shqipëria u pushtua nga Italia fashiste. Po ashtu dhe Kosova pak më vonë. Pas bashkimit të trojeve kombëtare gjatë pushtimit fashist dhe mes këtij përjetimi të fortë emocional, shqiptarëve ju duhej të merrnin një vendim i cili, nëse do të ishte i gabuar, më pas mund të kishte pasoja të pariparueshme për vetë çështjen kombëtare shqiptare. Ata duhej të vendosnin: Së pari, për të fituar Shqipërinë në kufijtë etnikë a duhej hequr dorë nga lufta kundër okupatorit fashist italian dhe, pas shtatorit 1943, kundër okupatorit gjerman? Së dyti, çfarë rruge duhej ndjekur për të siguruar edhe në të ardhmen bashkimin e trojeve etnike me Shqipërinë?

Me Kartën e Atlantikut të gushtit të vitit 1941, aleatët e kishin bërë të qartë se nuk njihnin pushtimin e Shqipërisë nga Italia fashiste. Mbi këtë parim ata nuk njihnin as copëtimin e Jugosllavisë, që kryen fuqitë e bllokut fashist në prill të vitit 1941. Në këtë mënyrë aleatët nuk njihnin as përfshirjen e Kosovës e të viseve të tjera brenda kufijve politikë të Shqipërisë së pushtuar. Bashkimi i tyre me Shqipërinë ishte realizuar në mënyrë të njëanshme, vetëm nga fuqitë e boshtit fashist, për rrjedhojë ai mund të kishte vlerë të mëtejshme, vetëm nëse luftën do ta fitonin Gjermania e Italia, gjë që kishte pak gjasa të ndodhte. Por edhe nëse ndodhte, çështja kombëtare shqiptare nuk ishte zgjidhur, Shqipëria përsëri do të vijonte të mbetej nën zgjedhën e Italisë fashiste, ajo ishte pjesë e gjeopolitikës së saj.

Në këto kushte, patriotët shqiptarë, duhet të kuptonin që fati i çështjes shqiptare nuk mund të lidhej me iluzionet e me premtimet e fuqive fashiste. Pavarësia e Shqipërisë dhe bashkimi i trojeve etnike, si dy objektiva madhorë të Lëvizjes Kombëtare nuk mund të shiheshin jashtë dhe të pavarura nga zhvillimet gjeopolitike rajonale e ndërkombëtare. Lufta dhe përpjekjet për arritjen e tyre nuk do të ishin një proces i shkëputur nga këto zhvillime. Gjatë

kësaj kohe Lëvizja kombëtare shqiptare e orientoi drejt popullin shqiptar. Ajo nuk lejoi që Shqipëria të renditej me humbësit.

Por, mbeti pa zgjidhje çështja e shqiptarëve në trojet etnike jashtë kufijve të Shqipërisë. Ndonëse në Bujan ishte vendosur që Kosova do t'i bashkohej Shqipërisë, shpejt u pa se, në lidhje me shqiptarët, Jugosllavia e Titos nuk kishte aspak ndryshime nga Jugosllavia e vjetër monarkiste e Karagjorgjeviçëve.

#### **8. Lufta e Ftohtë ngrin çështjen kombëtare shqiptare**

Pas Luftës së Dytë Botërore, fuqitë fituese thirrën, në gusht të vitit 1946, në Paris, Konferencën e Paqes, e cila do të ndërtonte hartën e re gjeopolitike të Evropës pas luftime. Shqipëria në këtë konferencë ishte radhitur në anën e fituesve të Luftës Antifashiste.

Edhe pas luftës së Dytë Botërore, hapësira gjeopolitike shqiptare mbeti e ndarë në tre shtete, të cilat përfaqësonin tre botë, në luftë ideologjike me njëra tjetrën. Çështja kombëtare shqiptare në këto rrethana ishte determinuar nga një luftë ideologjike, tipike për periudhën e Luftës së Ftohtë, luftë e cila për kushtet e Evropës Lindore, renditej mbi çështjet e tyre kombëtare. Në këto kushte dukej sikur Lufta e Ftohtë ngriu edhe çështjen kombëtare shqiptare.

Ndërkohë, shqiptarët e Kosovës, dhe sidomos një brez i ri evropianizuar intelektualësh dhe studentësh, çdo ditë e më tepër po ndërgjegjësoheshin për të fituar të drejtat e tyre kombëtare. Në nëntor 1968, pas vitesh dhune sistematike të agjensive serbe të sigurisë, sidomos gjatë kohës kur ato i drejtonte Aleksandër Rankovicit, studentët e Universitetit të Prishtinës u hodhën në demonstrata. Lëvizja, ndonëse u shtyp me dhunë, rezultoi me disa fitore për shqiptarët. Për herë të parë ata u përfaqësuan jo vetëm në organet e Republikës së Serbisë, por dhe në ato të federatës. Gjuha shqipe u duk sikur mori frymë lirisht. Filloi një bashkëpunim në fushën kulturore dhe shkëmbim profesorësh ndërmjet Universiteteve të Prishtinës e Tiranës. Tashmë në Prishtinë, por dhe në Shkup e Tetovë, po rritej një brez i aftë dhe i vendosur për të kërkuar të drejtat kombëtare të shqiptarëve dhe realizuar objektivat e mbetura të Rilindjes Kombëtare Shqiptare.

#### **9. Shpërbërja Jugosllavisë, pavarësia e Kosovës, marrëveshja e Ohrit dhe "shkrirja" e çështjes kombëtare shqiptare.**

Vdekja e Titos, rizgjimi i nacionalizmave në ish Jugosllavi, ardhja e Milloshevicit në krye të Lidhjes Komuniste të Serbisë, në maj 1986, fushata e tij historike nacionaliste e shoqëruar me dhunën ndaj shqiptarëve dhe suprimimi prej tij i statusit të krahinave autonome të Kosovës e Vojvodinës, paralajmëronte ditë të këqija dhe vuajtje për shqiptarët.

Duke humbur besimin se me lëvizjen e tyre paqësore do të siguronin mbështetjen ndërkombëtare për çështjen e tyre kombëtare, shqiptarët e Kosovës ashpërsuan qëndrimin dhe filluan lëvizjen e armatosur. Millosheviçi, pas kësaj, vuri në zbatim planin e tij për spastrimin etnik të shqiptarëve të Kosovës, duke synuar njëkohësisht destabilizimin dhe të Shqipërisë e Maqedonisë. Vetëm atëherë kancelaritë Perëndimore u detyruan të reagonin

ushtarakisht ndaj gjenocidit serb ndaj shqiptarëve etnikë. NATO, nëpërmjet sulmeve të armatosura ajrore dhe në bashkëpunim me UÇK-në në terren, çliruan përfundimisht Kosovën nga pushtuesi serb.

Ndërkohë edhe shqiptarët që jetonin në trojet e tyre, tashmë brenda kufijve shtetërorë të Maqedonisë, pas pavarësimit të saj ishin ngritur për të fituar të drejtat e tyre kombëtare. Pas përpjekjesh të gjata dhe konsumimit pa rezultat të të gjitha mundësive për të siguruar të drejtat e tyre në rrugë paqësore, si dhe agresivitetit në rritje të nacionalizmit maqedonas, shqiptarëve të Maqedonisë nuk u mbeti rrugë tjetër veçse t'i drejtohen armëve. Kështu në vitet 2000-2001, si pasojë e keqmenaxhimit të marrëdhënieve me shqiptarët etnikë, edhe Maqedonia u përfshi në dhunën e një konflikti të armatosur, i cili rrezikonte jo vetëm sigurinë e Maqedonisë, por edhe të të gjithë rajonit. Lufta e armatosur në Maqedoni ishte rezultat i pabarazisë dhe diskriminimit të shqiptarëve. Megjithatë, duke iu përmbajtur parimeve universale ndërkombëtare për mosndryshimin e kufijve, shqiptarët nuk synuan shpërbërjen e Maqedonisë. Ishte ndërhyrja e faktorit ndërkombëtar dhe "presioni" i NATO-s ajo që i detyroi, si maqedonasit dhe shqiptarët të nënshkruanin "Marrëveshjen e Ohrit". Nëse zbatohet plotësisht kjo marrëveshje, i rikthen shqiptarëve atje të drejtat juridiko-kushtetuese dhe statusin e popullit shtet formues. Kjo marrëveshje vendosi në letër mekanizmin e konsensusit, përmes së cilës në mënyrë legale, në institucione të sistemit, mund të mbrohet interesi kombëtar i popullit shqiptar.

Por si u zhvillua dinamika e zbatimit të Marrëveshjes së Ohrit? Fillimi i implementimit të Marrëveshjes së Ohrit ishte i ngadalshëm dhe i zbehtë. Faktori kryesor i neglizhimit dhe i ngadalësimit të zbatimit të kësaj marrëveshjeje ishte pala maqedonase, e cila u mundua maksimalisht që ky dokument të përfundojë me reduktime të mëdha. Një pjesë e klasës politike maqedonase akoma nuk është pajtuar me mendimin se shtetin e Maqedonisë e kanë bashkë me shqiptarët, si grupi më i madh etnik pas sllavo-maqedonasve. Maqedonisë për të mbijetuar si shtet i duhet patjetër të menaxhojë mirë raportet me shqiptarët etnikë, si grupi më i madh pas maqedonasve, grup i cili është kompakt dhe autokton në trojet e tij në Maqedoninë Perëndimore, troje të cilat janë pjesë e pandarë e hapësirës gjeopolitike të shqiptarëve në rajon.

Pasiguria mbi të ardhmen e Maqedonisë sot shtohet edhe për faktin se njëri nga subjektet politike maqedonase, nënshkrues të marrëveshjes së Ohrit, herë pas here ka dhënë shenja se është gati të heqë dorë nga zbatimi i saj dhe ka përkrahur një projekt të Akademisë së Shkencave të Shkupit për ndarjen e Maqedonisë.

Pa zbatimin e plotë dhe pa ekuivokë të Marrëveshjes së Ohrit nuk mund të ketë Maqedoni me shqiptarë dhe në kufijtë e saj të sotëm. Nëse dështon zbatimi i plotë i Marrëveshjes së Ohrit, rrezikohet përsëri paqja dhe stabiliteti

i Evropës Juglindore dhe do të ketë përsëri lëvizje tektonike në gjeopolitikën ballkanike

Por a mund të konsiderohet se çështja e shqiptarëve në Ballkan, pra çështja jonë kombëtare, të jetë zgjidhur përfundimisht sipas programin të Rilindjes Kombëtare?

Pas shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë programi i rilindjes Kombëtare dhe çështja kombëtare shqiptare u zgjidh vetëm pjesërisht. Programi i plotë i Rilindjes parashikonte të përfshinte në kufijtë e Shqipërisë, të gjitha trojet etnike shqiptare. Shpallja e pavarësisë së Kosovës dhe nënshkrimi i marrëveshjes së Ohrit, shënojnë një fitore historike për shqiptarët në rajon, një hap mjaft të rëndësishëm drejt zgjidhjes përfundimtare të çështjes sonë kombëtare. Në të njëjtën kohë janë dhe një investim serioz për paqen e sigurinë rajonale.

Por, aktualisht Marrëveshja e Ohrit është shtrembëruar dhe zbatimi i saj është vënë në dyshim nga vetë autoritetet maqedonase; çështja e Çamërisë dhe e pronave të shqiptarëve atje nuk ka marrë asnjë "drite jeshile" nga pala greke; në Kosovën Lindore (Preshevë, Medvegjë e Bujanovc) vazhdon të kryhet një spastrim i heshtur entik; edhe shqiptarët në trojet e tyre në Malin e Zi nuk i gëzojnë të drejta e tyre sipas standardeve ndërkombëtare. Për këtë, ndonëse është shënuar një hap mjaft i rëndësishëm drejt zgjidhjes përfundimtare të çështjes sonë kombëtare, çështja e shqiptarëve në Ballkan nuk mund të quhet e mbyllur.

#### **10. Çështja shqiptare në Ballkan dhe politikat e sigurisë kombëtare për zgjidhjen e saj.**

Por a mund të zgjidhet përfundimisht çështja shqiptare në Ballkan sipas programit të Rilindjes Kombëtare, që do të thotë duke u bashkuar të gjitha trojet në një shtet të vetëm? Cilat janë politikat e sigurisë kombëtare për zgjidhjen e saj?

Ideja për një bashkim kombëtar të shqiptarëve në një shtet të vetëm parashikohet dhe në preambulën e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Në të thuhet: "... Ne, Populli i Shqipërisë, krenarë dhe të vetëdijshëm për historinë tonë, me përgjegjësi për të ardhmen... me aspiratën shekullore të popullit shqiptar për identitetin dhe bashkimin kombëtar..."

Në zbatim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, zgjidhja përfundimtare e çështjes kombëtare shqiptare, e cila përbënte programin madhor të Rilindjes Kombëtare është përfshirë në politikat e sigurisë kombëtare të Republikës së Shqipërisë. Çështja Kombëtare Shqiptare është përcaktuar në këtë politikë si një nga objektivat parësorë të sigurisë, për t'u realizuar në planin afatshkurtër e afatmesëm.

Shqipëria, në strategjinë e saj të sigurisë kombëtare, hapur dhe pa asnjë ekuivok ka mbështetur pavarësinë e Kosovës dhe i ka paraprirë asaj. Në të përcaktohej qartë se, pa zgjidhjen përfundimtare të këtij statusi, nuk mund të ketë stabilitet dhe integrim rajonal.

Në të vërtetë politikat tona të sigurisë kombëtare, ndonëse nuk e pohojnë, nuk e përjashtojnë përfshirjen e mbarë trojeve shqiptare në një shtet të vetëm kombëtar si zgjidhjen përfundimtare të çështjes kombëtare shqiptare. Të kërkuar grumbullimin e vëllezërve në një shtëpi të përbashkët, nuk do të thotë të krijosh një Shqipëri të “madhe”.

Por, në politikën e sigurisë, është përcaktuar gjithashtu dhe rruga se “Çështja Kombëtare Shqiptare synohet të arrihet nëpërmjet integritit evropian dhe euroatlantik të vendeve të rajonit si edhe zgjidhjeve që sigurojnë garanci afatgjatë dhe të pranueshme për bashkësinë ndërkombëtare.”

### **11. Disa përfundime.**

1. Evoluimi nga mendimi se paqja në Ballkan arrihej duke copëtuar trojet etnike shqiptare deri tek bindja se pa zgjidhur çështjen shqiptare nuk mund të ketë paqe e siguri në rajon është një zhvillim mjaft i rëndësishëm për zgjidhjen përfundimtare të çështjes kombëtare shqiptare, por dhe të çështjes shqiptare në rajonin e Ballkanit.

2. Krijimi i shtetit të pavarur të Kosovës dhe skenarët e mundshëm paqësorë të zhvillimeve të mëvonshme, po krijojnë kushtet e zgjidhjes më të mirë të mundshme të çështjes shqiptare në Ballkan.

3. Ekzistojnë të gjitha mundësitë që Shqipëria dhe Kosova, në një moment të përshtatshëm në të ardhmen, duke qenë dy shtete të pavarura dhe sovranë, me vullnetin e qytetarëve të tyre të shprehur në referendume popullore dhe në kushtet e moskundërshtimit të shumicës së aktorëve kryesorë gjeopolitikë ndërkombëtarë, të vendosin bashkërisht për të ardhmen e tyre.

4. Sot, në kushtet e integritit euroatlantik nuk mund të pretendojmë zgjidhjen përfundimtare të çështjes sonë kombëtare siç e kishin parashikuar rilindasit tanë, pra bashkimin e të gjithë hapësirës gjeopolitike shqiptare në një shtet të vetëm.

5. Zgjidhja më të mirë e mundshme e çështjes shqiptare ndikon pozitivisht dhe forcon paqen e sigurinë rajonale.